



KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

01. nr. 561 - 295634, më 05.12.2016

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), në bazë Rregullores nr. 04/2016 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit të nenit 30 paragrafi 1 dhe nenit 32, paragrafi 4 të kësaj Rregulloreje, të nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, dhe Vendimit të Komisionit Komunal për Riintegrim në Komunën e Prishtinës, të dt. 06.12.2016, Kryetari i Komunës së Prishtinës më 07.12.2016, merr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e **Bekim Tahiri** me 8 anëtarë të familjes, të riatdhesuar nga Gjermania më 12.11.2016 për mbështetje nga programi i Riintegrimit për *Riintegrim* sipas kërkesës nr. 561-295634, të datës 05.12.2016 të parashtruar Komisionit Komunal për Riintegrim në Komunën e Prishtinës.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më 06.12.2016 ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga i riatdhesuari **Bekim Tahiri** nr. 561-295634, të datës 05.12.2016 në Komunën e Prishtinës për përfitim nga Programi i Riintegrimit për *riintegrim*.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara dhe sipas dëshmive të paraqitura, konstaton se i riatdhesuari **nuk i plotëson** kriteret për mbështetje nga Programi i Riintegrimit të përcaktuara me nenin 4, pika 2 të Rregullores QRK nr. 04/2016 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegrimit, ku përcaktohet se personat e riatdhesuar mund të jenë përfitues të ndihmës dhe mbështetjes të përcaktuara në nenet 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 21 të kësaj Rregulloreje, nëse e kanë lëshuar Kosovën para datës 28 Korrik të vitit 2010. Po ashtu, i riatdhesuari **Bekim Tahiri** prej vitit 1999 deri më 02.12.2014, kur e ka lëshuar Kosovën, ka jetuar në Fushëkosovë. Në bazë të nenit 33, pika 1, personi i riatdhesuar e parashtron kërkesën për përfitim nga programi i ZKKK-së në komunën përkatëse sipas vendbanimit që e ka pasur para se ta lëshoi Kosovën, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të tij, mund të paraqes ankesë në Komisionin e Ankesave.

U DËRGOHET

Qendrës për Shërbim me Qytetarë

ZKKK-së

Koordinatorit Rajonal të MBP-së

Bekim Tahiri

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

